



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 792/ 6 prot.

Datë 06/05/2025

V E N D I M
Nr. 621/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/05/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38954-02-21-2025, me objekt: “*Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore ne Spitalin Rajonal Gjirokastr Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 7,090,602 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.03.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastr.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK me NIPT L61814009B dhe me adresë: *Bradashesh Pasuria Nr. 1070, Zona Kadstrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan.*

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastr
Adresa: Lagjia “18 Shtatori”, Gjirokastr.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 24.02.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38954-02-21-2025, me objekt: “Trajtimi dhe

asgjesimi i mbetjeve spitalore ne Spitalin Rajonal Gjirokastr Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 7,090,602 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.03.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastr.

II.2. Në datën 06.03.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Më datë 20.03.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	<i>“Eco Riciklim” ShPK</i>	5,335,605	leke	<i>skualifikuar</i>
2	<i>“Medi-Tel ” ShPK</i>	5,427,000	leke	<i>kualifikuar</i>

II.4. Në datën 20.03.2025, operatori ekonomik “Eco Riciklim” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“- OE nuk ploteson Kriteri 2.3.8 Në rast të përdorimit të konteniereve njëpërdorimsh, të paraqitet një vetëdeklarim në të cilin të deklarohet se: kontenierët që ofrohen nga OE, janë brenda standarteve ligjore të kërkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore. Për të vertetuar përmbushjen e këtij kriteri OE, duhet të paraqesë: -Dokumentacionin për vertetimin e pronësise ose të marrjes me qera (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi)”.

II.5. Më datë 21.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

II.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5178, datë 25.03.2025 dhe me numër protokoli nr. 792/2025 datë 25.03.2025 e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38954-02-21-2025, me objekt: *“Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve spitalore ne Spitalin Rajonal Gjirokastr Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 7,090,602 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.03.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastr.* Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “Eco Riciklim” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të

dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 792/1 Prot, datë 26.03.2025, në lidhje me me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “Eco Riciklim” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 390/15 prot, datë 27.03.2025 “Kthim përgjigje Ankesës me numër aplikimi A/2025/5178”, protokolluar me tonën me nr. 792/2 prot, datë 01.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Në datë 07.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin nr. 390/14 prot, datë 27.03.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor, protokolluar me tonën me nr. 792/3 prot, datë 07.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklim” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “Eco Riciklim” SHPK mbi kundërshtimin e e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me pretendimin se: “- OE nuk ploteson Kriteri 2.3.8 Në rast të përdorimit të konteniereve njëpërdorimsh, të paraqitet një vetëdeklarim në të cilin të deklarohet se: kontenierët që ofrohen nga OE, janë brenda standarteve ligjore të kerkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore. Për të vertetuar përmbushjen e këtij kriteri OE, duhet të paraqesë: -Dokumentacionin për vertetimin e pronësise ose të marrjes me qera (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi)” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT ” pika 2.3.8 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“Kriteri 2.3.8: Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/përdorim, apo nëpërmjet çdo mënyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798, datë 29.09.2010, për miratimin e rregullores ⁴⁴ Për administrimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

A) Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1

B) Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1

C) Makineri për larjen e kontenierëve cope 1

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
- b) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
- c) Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerise;
- d) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

Në rast të përdorimit të konteniereve njëpërdorimsh, të paraqitet një vetëdeklarim në të cilin të deklarohet se: kontenierët që ofrohen nga OE, janë brenda standarteve ligjore të kerkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri OE, duhet të paraqesë:

-Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qera (ku afati i marrjes me qera të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);

*Shënim nr. 1: AK rezervon të drejtën, që përpara Njoftimit të Fituesit Përfundimtar të kryejë verifikime në instalimet e OE-ve të kualifikuar në SPE.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhenave per secilen pajisje nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST.**

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i**

kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë”.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B: “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.1.3. Në shtojcën 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” pika 2.1/a “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10

III.1.4. Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi ndër të tjera ka përcaktuar specifikimet teknike të kutive për ambalazhimin dhe evadimin e mbetjeve spitalore, si më poshtë vijon:

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIME TEKNIKE :

Për realizimin e shërbimit për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, operatori ekonomik duhet të sigurojë:

1- Furnizimin me bazën materiale të nevojshme për realizimin e ndarjes në burim dhe magazinimin provizor të mbetjeve spitalore deri në terheqjen e tyre, sipas kërkesave për secilin kod të mbetjeve spitalore.

Për këtë qëllim, Operatori Ekonomik duhet të vërë në dispozicion të AK, konteniere plastikë, qese plastike, kuti për të mprehtat, për përmbushjen e ambalazhimit referuar tipologjive të mbetjeve. Baza materiale duhet të jetë sipas standardeve dhe kërkesave të VKM nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, të Udhëzuesit Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore si dhe të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Kompania duhet të realizojë një furnizim të përshtatshëm në çdo kohë me materiale ndihmëse të nevojshme për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve.

I. Materialet ndihmëse duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent) “Mbrotjtja nga dëmtimi prej objekteve të mprehta - Kërkesat dhe metodat e testimit - Kontenierët (enët) e objekteve të mprehta”.
- Hapja të jetë aq e gjerë sa të lejojë që mbetjet spitalore të hidhen në kuti duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e mbetjes spitalore për të cilën është projektuar kutia për të mprehtat, hapja në kushte normale të përdorimit, të pengojë daljen/nxjerrjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të pajisur me kapakë të lëvizshëm, të jenë të projektuar në mënyrë të tillë që të mos jetë e nevojshme shtyrja me dorë e materialeve në kuti;
- Të jenë të tilla që të mbyllen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të mbyllura gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjithë llojet e kutive për të mprehtat të mos lejojnë rrjedhje;
- Të jenë të pajisura me dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropilene);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";

- Të jenë me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me kapak ngjyrë të kuq ose të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa, ku të lexohen qartë fjalët "RREZIK: TË MPREHTA TË NDOTURA" dhe të përmbajnë simbolin e biohazardit në etiketë.

Koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)

- Të jenë në përputhje me standardin SSH EN ISO 23907 – në variantin më të fundit të përditësuar (ose ekuivalent)
- Të tillë që të mbyllën në mënyrë të sigurtë;
- Rezistent ndaj rrjedhjes, thyerjes nga goditja dhe shpimet;
- Të jenë pa përbërje polivinilkloridi (PVC), të ndezshme dhe të djegshme në mënyrë të sigurt (Polypropylene);
- Të shkruhet qartë në to me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa përkatëse sipas pikës II të këtyre Specifikimeve "ETIKETIMI".

Shënim: Në rastin e koshave plastikë shumëpërdorimësh, duhet të garantohet larja dhe dezinfektimi i tyre në makinerinë përkatëse të specializuar dhe të vijnë të shoqëruar me qeset plastike përkatëse.

III.1.5. Për përmbushjen e kriterit kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.3.8 "Kapaciteti teknik" të Shtojcën 9 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT", operatori ekonomik ofertues "Eco Riciklim" SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës, si më poshtë vijon:

- Shtojcën 10 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", i vulosur dhe i firmosur nga administratori i shoqërisë, ku në Seksionin B "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit" ka deklaruar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
------------------	------------------

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <u>Profili i punonjësve</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: - Makineri per trajtimin dhe sterilizimin e mbetjeve: Impianti primar: Ecosteryl Model 250, kapaciteti i trajtimit 250-300 kg/ore. Rrymat e mbetjeve qe trajton 18.01.01; 18.01.02; 180103. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. Impianti back up: Neëster Model NË50, kapaciteti i trajtimit 90-110 kg/ore. Rrymat e mbetjeve qe trajton 18.01.01; 18.01.02; 180103. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. - Incinerator per asgjesimin e mbetjeve: Impianti primar: Mattheës Model Surefire TS 200, kapaciteti trajtimit 200 kg/ ore. Rrymat e mbetjeve qe trajton 18.01.01; 18.01.02; 18.01.03; 18.01.09. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. Impianti back up: Inciner8, Model P25 M1, kapaciteti trajtimit 100 kg/ ore. Rrymat e mbetjeve qe trajton 18.01.01; 18.01.02; 18.01.03; 18.01.09. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. -Makineri per larjen dhe dezinfektimin e kontenitoreve. Impianti primar: PRC Impianti, Model PI-LVG-15E,
--	---

	kapaciteti i larjes 160 kontenitore/ore. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. Impianti back up: PRC Impianti, Model PI-LVG 15E, kapaciteti i larjes 160 kontenitore/ore. Impianti eshte i perfshire ne Lejen Mjedisore Tipi A (kodi III.1.C) dhe Licencen perkatese III.2.B. Peshore te kalibruara nga DPM. Automjete per transportin e mbetjeve te rrezikshme spitalore me targa: AA 489 YL; AA 506 OH, AA 487 SB; AA 447 SU; AB 486 BO; AA 914 SJ; AA 862 PS, AA 684 ZA, AB868ID, AB 378 IJ; AB 241 SB.
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Dokumentin “DEKLARATË” të bërë nga administratori i shoqërisë “Eco Riciklim” SHPK me përmbajtjen si më poshtë:

“Të nderuar zotërinj,

Unë Ervin MECE, përfaqesues dhe administrator i vetëm i Shoqërisë “ECO RICIKLIM” sh.p.k, me NIPT: L61814009B, me seli ne adresën Elbasan, Metalurgji, Bradashesh, Pasuria Nr. 1070, Zona Kadstrale 3965, dhe objekt veprimtarie: Pastrim, grumbullim, përpunim, transport dhe asgjësim i mbetjeve spitalore apo mbetjeve të tjera të ngjashme, deklaroj se: Kontenitorët njëpërdorimsh që do të ofrohen nga Operatori Ekonomik “ECO RICIKLIM” Sh.p.k për ambalazhimin e mbetjeve spitalore janë brenda standarteve ligjore të kërkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Me respekt,
ADMINISTRATORI”.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.
- 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.
- 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm

ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga

autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.1.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht :

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti

ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.12. Nga shqyrtimi i Shtojcës 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve

spitalore përfshin dhe vënien në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik të materiale ndihmëse , ku këto materiale përfshijnë materialet si në vijim: “*Kuti për të mprehtat (brenda diapazonit 3 – 12 Litra) dhe koshat plastikë (brenda diapazonit 40 – 60 Litra)*”, të cilët mund të jenë njëpërdorimësh ose shumë përdorimësh, duke parashikuar që në rastin kur janë shumëpërdorimësh operatori ekonomik të sigurojë larjen e tyre pas përdorimit.

Gjithashtu autoriteti kontraktor për tu siguruar se operatori ekonomik ofertues i kapacitetet për të disponuar këto materiale ndihmëse, në kriterin kualifikues në pikën 2.3.8 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit ka përcaktuar që në rastin kur operatori ekonomik ofertues do të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor materiale ndihmëse të nevojshme për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve njëpërdorimësh, duhet që të pasqyrojë në shtojcën 10 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “*Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, seksioni B: “*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” se i disponon këto materiale, si dhe duhet të dorëzojë një deklaratë ku të deklarojë se kontenierët (materialet ndihmëse) që ofrohen nga OE janë brenda standarteve ligjore të kerkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe në rastin kur këto, duke dorëzuar njëkohësisht në fazën e ofertimit edhe dokumentacionin që vërteton pronësinë e këtyre materialeve ndihmëse ose dokumentacionin që vërteton marrjen me qera të këtyre materialeve ndihmëse .

III.1.13. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “*Eco Riciklimi*” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit, Komisioni konstaton se ofertuesi ka deklaruar se në rast se do të shpallet fitues i kësaj procedure do të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor materiale ndihmëse njëpërdorimësh, të cilat do të jenë standarteve ligjore të kerkuara në fushën e mbetjeve të rrezikshme spitalore, por nuk ka deklaruar në shtojcën 10 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “*Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, seksioni B: “*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” se i disponon këto materiale sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar dhe për më tepër nuk ka dorëzuar asnjë dokument provues që të vërtetojë disponimin e tyre.

Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik “*Eco Riciklimi*” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se disponon materiale ndihmëse njëpërdorimësh të nevojshme për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve, duke mos plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka deklaruar në shtojcën 10 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III,

“Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, seksioni B: “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” dhe për më tepër nuk ka dorëzuar në dokumentacion që të vërtetojë disponimin e këtyre materialeve ndihmëse.

Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Riciklimi” SHPK në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.8. “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit.

Përsa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Eco Riciklimi” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eco Riciklimi” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-38954-02-21-2025, me objekt: “Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore në Spitalin Rajonal Gjirokastrë Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 7,090,602 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 06.03.2025 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklimi” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro